# DËSHMI ARKIVI

**A-454973**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Von der Leyen anashkalon Serbinë dhe Bosnjën në turneun e saj në Ballkan – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/von-der-leyen-anashkalon-serbine-dhe-bosnjen-ne-turneun-e-saj-ne-ballkan/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 11:56:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 11:55:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `11e5b4c734b03f457f82dbfbcc3428867d3059eb2d1914f1cd6e1924220b3b91` |
| TEKSTI | `5f148976b7511600e4cb7d77172eb6f635ae5c6c7e1f4b0319eaf97e9e207148` |
| PAMJA | `2915bdb6b07349b5d36989a52d13df9de5c567725ea406eea7a3669d833e74d2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `23b42d571ebc0cb54eacac743f8cd6aae41223cbf1773f70f96657f3a4b1f754` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4f41e4bbd5d1a7a4ac13493ee37230fd53ce6e6428b4fbf05933a9d422fc171d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/23b42d571ebc0cb54eacac743f8cd6aae41223cbf1773f70f96657f3a4b1f754`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

"Gjatë turneut, presidentja von der Leyen do të vizitojë Tiranën, Prishtinën, Podgoricën dhe Shkupin. Atje do të takohet me presidentët dhe kryeministrat, si dhe do të vizitojë projekte të financuara nga Bashkimi Evropian", tha zëdhënësja e Komisionit Evropian, Arianna Podesta.

Vizita në katër vendet e rajonit është paraparë të zhvillohet nga 30 shtatori deri më 2 tetor.

Radio Evropa e Lirë kishte raportuar më herët për mundësinë që von der Leyen, nëse nuk do ta vizitonte Serbinë, të mos shkonte as në Bosnjë e Hercegovinë.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, prej vitesh ka pasur një raport të ngrohtë me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, të cilit shpesh i është drejtuar me fjalët "i dashur Aleksandar". Kjo qasje është kritikuar nga ekspertë që merren me Ballkanin Perëndimor.

Ishte spekuluar se von der Leyen nuk do ta vizitonte Serbinë gjatë turneut ballkanik për shkak të tensioneve politike dhe shoqërore në vend, ndërsa varrimi i Ratko Mlladiqit, i dënuar për krime lufte dhe gjenocid, kishte nxitur reagime të ashpra në Bashkimin Evropian. Edhe disa deputetë të Parlamentit Evropian i kishin bërë thirrje shefes së Komisionit Evropian që të mos udhëtonte në Beograd.

Në prag të zgjedhjeve parlamentare dhe të përgjithshme në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë, presidentja e Komisionit Evropian planifikon t'i vizitojë këto dy vende më vonë, tha Podesta.

5 "Takove rusin që i hapi rrugë ngritjes së Gjykatës Speciale", Balla akuza...

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

vizitojë këto dy vende më vonë, tha Podesta.

Ky do të jetë turneu i gjashtë i von der Leyen në rajon, një vizitë që tashmë është bërë traditë para publikimit të paketës vjetore të raporteve të progresit për vendet kandidate për anëtarësim në BE.

"Siç tha presidentja në samitin e qershorit, Bashkimi ynë nuk do të jetë i plotë pa Ballkanin Perëndimor. Gjatë bisedimeve me partnerët, ajo do të diskutojë për hapat e nevojshëm në rrugën e këtyre vendeve drejt Bashkimit Evropian, si dhe për procesin e integrimit gradual, të mbështetur nga Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor", tha zëdhënësja Podesta./rel

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh




BOTA
**Zbulohet "super-aplikacioni" i Rusisë...**
Xhuljana Zhuleku · 26 minuta më parë



BOTA
**Sulm fatal nga peshkaqeni në...**
Xhuljana Zhuleku · 55 minuta më parë



BOTA
**Tragjedi në Athinë, 3 të rinj shqiptarë...**
Xhuljana Zhuleku · 2 orë më parë

## Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.